



NDIKIMI I PAGESËS SË QESEVE TË PLASTIKËS TE QYTETARËT E KOMUNËS SË PRIZRENIT

DHJETOR, 2024



NDIKIMI I PAGESËS SË QESEVE TË PLASTIKËS TE QYTETARËT E KOMUNËS SË PRIZRENIT

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren,

Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 / 038 224 967

Hulumtimi "Ndikimi i pagesës së qeseve të plastikës te qytetarët e Komunës së Prizrenit" është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj Human Rightvis që implementohet nga Community Development Fund CDF.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



Dhjetor, 2024

HYRJE

Të drejtat mjedisore të njeriut përfshijnë të drejtën për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, të cilat janë të pandashme nga të drejta themelore si ajo për jetë, shëndet dhe mirëqenie. Këto të drejta janë një element kyç për mirëqenien e individëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Në Kosovë, këto të drejta mbështeten nga Kushtetuta dhe ligje përkatëse, por shpesh sfidat e zbatimit dhe mungesa e ndërgjegjësimit kufizojnë përfitimet e tyre të plota.[1]


Qeset plastike kanë depërtuar thellë në jetën tonë të përditshme për shkak të komoditetit që ofrojnë. Të lira dhe të lehta për t'u përdorur, ato ofrojnë një zgjidhje të shpejtë për transportimin e mallrave, por kjo lehtësi ka një kosto të madhe për mjedisin. Sot, përdorimi i qeseve plastike ka arritur nivele alarmante, duke tejkaluar kapacitetin për menaxhim dhe riciklim. Problemi i mbetjeve plastike është bërë një krizë globale, që kërkon zgjidhje të menjëhershme dhe të qëndrueshme. Qeset plastike prodhohen kryesisht nga lëndë fosile, një proces që kontribuon në ndotjen e ajrit dhe emetimin e gazrave serrë. Pasi përdoren, ato shpesh përfundojnë në deponi, ku qëndrojnë për qindra vjet, duke lëshuar kimikate të dëmshme që ndotin tokën dhe ujërat. Ky produkt njëpërdorimësh nuk degradohet natyrshëm dhe ndikon negativisht në ekosistemet, duke bllokuar puset, lumenjtë dhe shtigjet e ujërave dhe duke vështirësuar jetesën për gjallesat e ndryshme.[2]

[1]

https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/201202110304_rudhezuesi_per_te_drejtat_e_njeriut_ndaj_mjedisit_ne_kosove.pdf

[2]

https://lochtree.com/blogs/blog/environmental-impact-of-plastic-bags?fbclid=iwy2xjawgg9_zlehrua2flbqixmaabhfw7cwlwj0gye9cjt0jnciyi5etbd4_mgbj-oqrichklohkbfcphsqvz6g_aem_9tnguvkjcffs39ayvxcimw



Ndotja nga plastika është gjithashtu pjesë e synimeve të përfshira në listën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZhQ/SDG), pasi trajtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga disa prej këtyre objektivave. Ajo theksohet në objektivën e 12, e cila promovon konsum dhe prodhim të qëndrueshëm duke synuar reduktimin e mbetjeve përmes riciklimit dhe ripërdorimit; në objektivën e 14, ku adresohet ndikimi i ndotjes nga plastika në ekosistemet detare dhe jetën nën ujë; dhe në objektivën e 15 e cila fokusohet në mbrojtjen e ekosistemeve tokësore nga ndotja dhe degradimi. Këto synime nënvizojnë rëndësinë e reduktimit të ndotjes nga plastika për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.[3]

Në shumë vende, vendosja e taksave mbi qeset plastike ka rezultuar si metodë efektive për uljen e përdorimit të tyre. Këto masa kanë synuar të nxisin konsumatorët të përdorin alternativa më të qëndrueshme, si qeset e ripërdorshme prej pambuku organik ose materiale të tjera të riciklueshme. Përveç taksave, rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i alternativave të qëndrueshme janë hapa të rëndësishëm për të reduktuar varësinë tonë nga plastika njëpërdorimshme.[4]

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë adoptuar qasje që synojnë reduktimin e qeseve plastike përmes ligjeve që kufizojnë prodhimin dhe përdorimin e tyre. Në Shqipëri, ndalimi total për qeset plastike njëpërdorimshme është në fuqi që nga qershori 2022, ku janë përfshirë gjithashtu ndalimet për qeset plastike okso-degradueshme. Kjo politikë u ndihmon qytetarëve të fokusohen te zgjidhje më të qëndrueshme, dhe ligji imponon gjoba të larta për bizneset që nuk respektojnë ndalimin.[5]

[3]
<https://sdgs.un.org/goals>

[4]
https://lochtree.com/blogs/blog/environmental-impact-of-plastic-bags?fbclid=iwy2xjawgg9_zlehrua2flbqixmaabhfw7cwlwj0gye9cjt0jnciyi5etbd4_mgbj-oqrichk1ohkbfcpshsqvz6g_aem_9tnguvkjcfss39ayvxcimw

[5]
https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/ligj_10463_22.09.2011-per-menaxhimin-e-integruar-te-mbetjeve.doc

Në Maqedoninë e Veriut, nga dhjetori 2021 qeset plastike të biodegradueshme shiten me një tarifë prej 15 denarësh (rreth 0,25 €), me qëllim që të kufizohet përdorimi i tyre. Të ardhurat nga këto tarifa përdoren për projekte të menaxhimit të mbetjeve dhe përmirësimin e mjedisit. Ky sistem i tarifave i jep qytetarëve një zgjedhje më të përgjegjshme dhe ndihmon në përmbushjen e objektivave për zvogëlimin e ndotjes.[6]

Në Mal të Zi, qeset plastike dhe plastika njëpërdorimshme janë të ndaluara që nga prilli 2021. Kufizimet përfshijnë qeset me trashësi të murit nga 15 deri në 50 mikron. Për qeset me trashësi mbi 50 mikron, aplikohet një tarifë prej 0,03 €. Ligji parashikon gjoka të ashpra që shkojnë nga 1,000 deri në 40,000 € për shkelësit, duke siguruar një detyrim të fortë për bizneset dhe individët për të ulur përdorimin e plastikës njëpërdorimshme.[7]

Republika e Irlandës është një nga shembujt e parë të suksesshëm të përdorimit të taksave për qeset plastike që nga viti 2002. Taksa e vendosur pati ndikim të menjëhershëm, duke reduktuar përdorimin nga 328 në 21 qese për person në vit. Irlanda vazhdon të zhvillojë politika të ngjashme për produkte të tjera plastike, duke e bërë këtë një nga vendet udhëheqëse në këtë fushë. Ndërsa, në Afrikën Sub-Sahariane, Kenia ka ndërmarrë masa ekstreme për të ndaluar përdorimin e qeseve plastike, duke përfshirë dënime të ashpra, si gjoka deri në 40,000 \$ ose katër vite burg për ata që prodhojnë, shesin apo përdorin qese plastike. Ky ndalim aplikohet edhe për turistët, të cilët nuk mund të sjellin qese plastike në vend dhe janë të detyruar t'i dorëzojnë ato në pikat kufitare. [8]

[6]


[plani-kombëtar-për-menaxhimin-të-mbeturave-në-republikën-e-maqedonisë-së-veriut-2021-2031.pdf](#)

[7]

<https://www.gazetatema.net/rajoni/gjoka-deri-ne-40-mije-euro-mali-i-zi-nga-sot-ndalon-perdorimin-e-qeseve-p-i462892>

[8]

<https://www.koha.net/veshtrime/si-funksionojne-ne-praktike-kufizimet-e-perdorimit-te-qeseve-plastike>



Këto masa kanë sjellë rezultate pozitive, si shpallja e qytetit të Kigali në Ruandë si më i pastri në Afrikë. [8]

Në mënyrë të ngjashme, Afrika e Jugut ka vendosur taksa për qeset plastike që nga viti 2003, duke ndikuar ndjeshëm në uljen e përdorimit të tyre.[9]&[10]

Në përgjithësi, vendet që kanë përdorur mekanizma të ndryshëm ekonomikë, përfshirë tarifatat apo taksat, kanë arritur të reduktojnë ndjeshëm përdorimin e qeseve plastike. Qeset plastike përbëjnë një sfidë të vazhdueshme për mjedisin edhe në Kosovë, duke kontribuar ndjeshëm në ndotjen e tokës dhe ujit, si dhe duke ndikuar negativisht në biodiversitet dhe shëndetin publik. Me rritjen e konsumit të tyre, ndikimi negativ është bërë gjithnjë e më evident, duke nxitur nevojën për ndërhyrje konkrete. Për të frenuar përdorimin e tepërt të qeseve plastike dhe për të promovuar një qasje më të qëndrueshme ndaj menaxhimit të mbetjeve, Kosova ka ndërmarrë hapa ligjorë që përqendrohen në reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin e ambalazhit plastik.

[8]


<https://www.koha.net/veshtrime/si-funksionojne-ne-praktike-kufizimet-e-perdorimit-te-qeseve-plastike>

[9]

<https://bioplasticsnews.com/2020/01/03/single-use-plastic-bans-geneva/>

[10]

<https://www.theguardian.com/environment/2017/aug/28/kenya-brings-in-worlds-toughest-plastic-bag-ban-four-years-jail-or-40000-fine>




Ligji për qeset plastike dhe ndryshimet ligjore në Kosovë

Më 1 shtator 2022, hynë në fuqi pako e re ligjore që ndryshoi Ligjin për Mbeturina, për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të ambalazhit, përfshirë qeset plastike. Kjo u forcua më tej me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2023, i cili u miratua më 18 nëntor 2022 nga Qeveria e Kosovës, duke vendosur kritere të reja për prodhuesit, importuesit, dhe shitësit e qeseve plastike.

Qëllimi kryesor i këtij udhëzimi është të zvogëlojë ndikimin mjedisor të qeseve plastike dhe të nxisë kalimin drejt një ekonomie qarkore përmes masave si parandalimi i mbetjeve, rritja e nivelit të ripërdorimit dhe riciklimi i ambalazhit. Udhëzimi përshkruan objektiva konkrete për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike mbajtëse me peshë të lehtë, duke përcaktuar që deri në fund të vitit 2024, përdorimi vjetor i këtyre qeseve nuk duhet të kalojë 180 qese për person, dhe deri në vitin 2030, ky numër të zbresë në vetëm 40 qese për person. Nëse këto objektiva nuk përmbushen, Ministria ka autorizimin për të marrë masa shtesë për të arritur synimet mjedisore. [11]

[11]


https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/LegislationDocs/2023_70670283-17f1-42fa-96d5-5843474b5c08.pdf



Kategoritë dhe masat për reduktimin e qeseve plastike në Kosovë

Në këtë kuadër, qeset plastike ndahen në disa kategori: qese mbajtëse me peshë të lehtë dhe të rëndë, si dhe qese të bio-degradueshme dhe okso-degradueshme, ku secila ka trajtim të veçantë. Për qeset e lehta me dorëza, udhëzimi përcakton tarifa dhe masa të tjera për t'i kufizuar, duke përfshirë një ndalim të qeseve me trashësi më të vogël se 25 mikronë. Gjithashtu, ndalohet prodhimi, importi dhe shitja e qeseve okso-degradueshme, të cilat janë problematike për shkak të dekompozimit të pjesshëm në mikroplastikë.

Qeset bio-degraduese me certifikata të posaçme përjashtohen nga tarifat e detyrueshme, duke inkurajuar kështu përdorimin e materialeve më të qëndrueshme për konsumatorët. Çdo qese plastike me peshë të lehtë që shitet, duhet të evidentohet në kuponin fiskal, për të përmirësuar raportimin dhe monitorimin e përdorimit të tyre.




Raportimi dhe zbatimi i Ligjit në Kosovë

Prodhuesit dhe importuesit e qeseve plastike janë të detyruar të raportojnë në Agjencinë përkatëse deri më 31 mars të vitit vijues, për sasinë e qeseve të prodhuara dhe të importuara gjatë vitit paraprak. Për më tepër, Agjencia përmes analizës vlerëson arritjen e objektivave të vendosura, duke ndjekur të dhënat nga Dogana dhe Administrata Tatimore për qeset plastike të shitura. Përmes këtij ligji, Kosova synon të ndërtojë një sistem më të përgjegjshëm për menaxhimin e qeseve plastike, duke mbrojtur mjedisin dhe duke rritur ndërgjegjësimin publik mbi ndikimet e dëmshme të plastikës në jetën e përditshme dhe në ekosistemet natyrore. [12]


Në kuadër të përpjekjeve për të analizuar ndikimin e masës së pagesës për qeset plastike, EC Ma Ndryshe ka zhvilluar një hulumtim që synon të kuptojë se si kjo masë po ndikon tek qytetarët e Komunës së Prizrenit. Ky hulumtim është realizuar përmes anketave fizike dhe nëpërmjet rrjeteve sociale, duke ofruar mundësinë që çdo qytetar të japë kontributin e tij të vlefshëm në këtë proces. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej 150 qytetarë prej të cilëve 84 ose (56%) ishin burra dhe 66 ose (44%) ishin gra.

[12]



<https://www.koha.net/veshtrime/si-funksionojne-ne-praktike-kufizimet-e-perdorimit-te-qeseve-plastike>




A jeni të informuar se nga viti 2023 qeset e plastikës në Kosovë janë bërë me pagesë sipas Udhëzimit Administrativ 08/2023?



Sa shpesh përdorni qese plastike kur bëni blerje?




A mendoni se qeset e plastikës për të cilat paguani duhet të kenë logo ose emrin e kompanisë?




A mendoni se pagesa për qeset plastike do të ndihmojë në reduktimin e ndotjes nga plastika në Kosovë?





A do të preferonit që qeset plastike të ishin të ndaluara plotësisht në vend të pagesës për to?





Sa e rëndësishme është për ju që të kontribuoni në reduktimin e ndotjes së mjedisit?



A keni vërejtur ndonjë ndryshim në sjelljet e njerëzve të tjerë (familjarë, miq, bashkëqytetarë) pas futjes së pagesës për qeset plastike?



Cilat masa të tjera mendojnë se duhet të ndërmerren për të reduktuar përdorimin e qeseve plastike dhe ndotjen e mjedisit në Kosovë?




REZULTATET E HULUMTIMIT:

Ky hulumtim është i rëndësishëm për të kuptuar se si pagesa për qeset plastike ndikon në sjelljet dhe preferencat e konsumatorëve, duke ofruar një pamje më të qartë mbi shkallën e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ndikimin negativ të plastikës në mjedis dhe mundësitë për të promovuar zgjidhje më të qëndrueshme për mbrojtjen e mjedisit. Rezultatet e mëposhtme japin një përshkrim të hollësishëm për perceptimet, përdorimin dhe qëndrimet e qytetarëve lidhur me qeset plastike pas vendosjes së pagesës për to.


- Hulumtim ka identifikuar një nivel të lartë ndërgjegjësimi në lidhje me faktin që qeset plastike janë bërë me pagesë në Kosovë që nga viti 2023 sipas Udhëzimit Administrativ 08/2023. Në këtë rast, 93% e qytetarëve janë shprehur se janë të informuar për këtë ndryshim duke treguar kështu se përhapja e informacionit përmes kanaleve publike ose fushatave të vetëdijesimit ka qenë efektive.
- Përdorimi i qeseve plastike gjatë blerjeve mbetet ende i lartë, por ka sinjale të një prirjeje drejt reduktimit të tyre. Sipas rezultateve të hulumtimit vetëm 19% e të anketuarve i përdorin qeset gjithmonë, 33% të tjerë janë shprehur se i përdorin shumë shpesh dhe 31% qytetarë të tjerë thonë se qeset i përdorin ndonjëherë. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë treguar se i përdorin më rrallë 15% ose nuk i përdorin asnjëherë 2% qeset plastike. Kjo sjellje tregon një fazë të ndërmjetme të ndryshimeve ku disa qytetarë janë në procesin e reduktimit të përdorimit të qeseve plastike ndoshta si rezultat i pagesës së vendosur për to.




- Rreth 66% e qytetarëve tregojnë kanë konfirmuar se kanë filluar të përdorin më shumë alternativa si çanta të ripërdorshme ose qese letre, ndërsa 34% vazhdojnë të përdorin qeset plastike. Ky rezultat tregon një qasje pozitive drejt përdorimit të alternativave më të qëndrueshme në rritje të ndërgjegjësimit mjedisor duke reflektuar një angazhim të shtuar për mbrojtjen e mjedisit.
- Qytetarët që janë shprehur se kanë filluar të përdorin alternativat tjera për të zëvendësuar plastikën, në vazhdim janë pyetur se cilat janë arsyet kryesore që keni zgjedhur të përdorin alternativa tjera karshi qeseve plastike, ku 66% e qytetarëve kanë zgjedhur si arsye ndikimin pozitiv në mjedis, 44% janë shprehur se i kanë zgjedhur këto alternativa për shkak të kostos së qeses së plastikës dhe 21% qytetarë mendojnë se alternativat tjera janë më të lehta dhe më të qëndrueshme. Në përgjigjet e hapura disa qytetarë kanë deklaruar se dëshirojnë që të respektojnë ligjin dhe ta shohin Kosovën në përshtatje me standardet evropiane.
- Në lidhje me vendosjen e logos apo emrin e kompanisë në qeset plastike shumica e qytetarëve 67% nuk e shohin të nevojshme, ndërsa një pjesë e vogël e qytetarëve 27% janë shprehur se qeset plastike për të cilat paguajnë duhet të kenë logo ose emrin e kompanisë.



- Në lidhje me ndikimin e pagesës për qeset e plastikës në reduktimin e ndotjes, rreth 68% e qytetarëve besojnë se pagesa për qeset plastike do të ndihmojë në uljen e ndotjes nga plastika në Kosovë edhe pse 32% të tjerë mbeten skeptikë për efektivitetin e kësaj mase. Kjo tregon që qytetarët kanë një perceptim pozitiv për potencialin e pagesës si një mjet për të ndryshuar sjelljen ndaj qeseve plastike.
- 59% e të anketuarve do të preferonin që qeset plastike të ndaloheshin plotësisht duke sugjeruar kështu një gatishmëri për të miratuar masa më të rrepta mjedisore, 23% janë kundër këtij propozimi dhe 18% e tyre nuk kanë ndonjë mendim se si do donin të zgjidhej ky problem. Ky rezultat tregon që një pjesë e qytetarëve kanë një qëndrim të fortë ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe preferojnë masa më strikte për të reduktuar përdorimin e plastikës.
- Vlerësimi i rëndësisë së kontributit personal për reduktimin e ndotjes mjedisore është gjithashtu i lartë. Për 82% të qytetarëve është shumë e rëndësishme që të kontribuojnë në reduktimin e ndotjes së mjedisit, ndërsa 17% e shohin këtë çështje si mesatarisht të rëndësishme dhe vetëm 1% e tyre e shohin si aspak të rëndësishme. Ky rezultat thekson një nivel të lartë të ndërgjegjësimit mjedisor në komunitet dhe gatishmërinë e qytetarëve për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.



- Në lidhje me sjelljet e të tjerëve, pothuajse 49% e qytetarëve raportojnë se kanë vërejtur një reduktim të dukshëm në përdorimin e qeseve plastike nga shumica e njerëzve rreth tyre ndërsa 41% të tjerë kanë vërejtur ndryshime vetëm të një pjesë e popullsisë. Kjo tregon se pagesa ka filluar të ketë efekt në sjelljet kolektive edhe pse nuk është bërë ende një praktikë e përgjithshme.
- Sa i përket masave të tjera të mundshme për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike dhe ndotjes mjedisore 67% e qytetarëve preferojnë fushatat edukuese dhe vetëdijesuese. 45% e të anketuarve mbështesin edhe ndalimin e plotë të qeseve plastike, ndërsa 30% e qytetarëve të tjerë sugjerojnë rritjen e çmimit për blerjen e tyre si një masë alternative. Në përgjigje të hapur disa qytetarë propozuan që lokalet të mos imponojnë qeset plastike te klientët duke lënë më shumë zgjedhje tek konsumatorët për të refuzuar qeset e panevojshme.



PËRFUNDIME:

- Rezultatet tregojnë se qytetarët e komunës së Prizrenit kanë një nivel të lartë të ndërgjegjësimit rreth pagesës për qeset plastike që është zbatuar që nga viti 2023. Ky nivel informacioni reflekton angazhimin për të kuptuar pasojat e ndotjes plastike dhe përpjekjet e autoriteteve për ta adresuar atë.
- Përdorimi i alternativave për qeset plastike ka pësuar një rritje të dukshme të një pjesë e madhe e qytetarëve që kanë adoptuar çanta të ripërdorshme ose qese letre si zëvendësim. Ky ndryshim po i orienton qytetarët drejt një prirje pozitive për të zvogëluar përdorimin e qeseve të plastikës duke i zëvendësuar ato me materiale më të qëndrueshme.
- Shumica e qytetarëve besojnë se pagesa për qeset plastike do të kontribuojë në uljen e ndotjes plastike duke e konsideruar si një hap të dobishëm për përmirësimin e mjedisit. Megjithatë një pjesë e qytetarëve ende dyshojnë për efektivitetin e saj afatgjatë.
- Një numër i konsiderueshëm qytetarësh preferojnë që qeset plastike të ndalohen plotësisht duke kërkuar masa më të rrepta për reduktimin e përdorimit të plastikës dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Shumica e qytetarëve nuk e konsiderojnë të nevojshme që qeset plastike të kenë logo ose emrin e kompanisë duke i dhënë më shumë rëndësi qëllimit të pagesës për të ulur ndotjen plastike se sa promovimit të markave tregëtare.




REKOMANDIME:

Krijimi i një fushate gjithëpërfshirëse edukative - Organizimi i fushatave edukative dhe informuese për qytetarët mbi ndikimin negativ të plastikës në mjedis është thelbësor. Duhet të promovohen alternativat e qëndrueshme dhe të inkurajohen qytetarët që të kontribuojnë aktivisht në mbrojtjen e mjedisit. Kjo mund të bëhet përmes mediave lokale, shkollave, dhe grupeve shoqërore.

Nxitja e industrisë për adoptimin e materialeve të qëndrueshme - Bizneset, sidomos ato që merren me shpërndarjen e produkteve duhet të inkurajohen për të përdorur materialet alternative që janë më miqësore për mjedisin. Përshtatja e legjislacionit për të mbështetur përdorimin e materialeve të riciklueshme dhe bio-degradueshme është një hap i rëndësishëm.


Shtrirja e masave për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike - Një ndalim i plotë i qeseve plastike mund të jetë një zgjidhje afatgjatë për uljen drastike të ndotjes plastike. Shumica e qytetarëve mbështesin këtë masë, duke sugjeruar që autoritetet në vitet e ardhëshme të fillojnë shqyrtimin e mundësive për zëvendësimin e qeseve plastike me alternativa që nuk kanë ndikim të dëmshëm për mjedisin.



Përmirësimi i infrastrukturës për riciklimin e plastikës - Përdorimi i plastikës mund të ulet ndjeshëm nëse përmirësohet infrastruktura për riciklimin e materialeve plastike. Kjo mund të përfshijë krijimin e stacioneve të riciklimit të thjeshta dhe të qasshme si dhe një sistem të përshtatshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike.

Përfshirja e sektorit të arsimit në strategjitë e mjedisit - Shkollat dhe institucionet arsimore duhet të jenë pjesë e iniciativave për edukimin mjedisor. Krijimi i aktiviteteve dhe projekteve që nxisin nxënësit të përdorin materiale të qëndrueshme dhe të promovojnë riciklimin do të ndihmonte që gjeneratat e reja të jenë më të ndërgjegjshme për mjedisin.

Rritja e kontrollit dhe inspektimeve për implementimin e ligjit - Është e rëndësishme që autoritetet të sigurojnë një implementim më të rreptë të ligjit për pagesën e qeseve plastike për të parandaluar shmangien e këtij rregulli dhe për të siguruar që masa të tilla të jenë efektive.




Mbështetje për sektorin privat në përdorimin e materialeve ekologjike

- Bizneset që shesin produkte të paketuara duhet të mbështeten dhe inkurajohen të përdorin materiale alternative të qëndrueshme. Për këtë mund të krijohen shpërblime ose subvencione për ato kompani që kalojnë në përdorimin e alternativave të riciklueshme.

Përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse


- Qytetarët duhet të jenë pjesë e proceseve vendimmarrëse dhe të kenë mundësi të kontribuojnë në formulimin e politikave që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Kjo mund të realizohet përmes grupeve të interesit, takimeve publike dhe sondazheve të rregullta që mundësojnë një përfshirje më të gjerë të opinionit qytetar.



PËR EC:

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:


1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale.
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për pale të treta.



Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen,
2. Qëndrueshmërinë, dhe
3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.




Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkë veprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;

3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;

4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.





WWW.ECMANDRYSHE.ORG